

AKTET E PARA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË QYTETARIT

1. KARTA E MADHE E LIRIVE (KARTA MAGNA LIBERTATUM) 1215

Pa u mbështetur në ligj dhe në vendim të ligjshëm:

- Askush nuk mund të **burgoset**,
- Askush nuk mund të **privohet nga pasuria**,
- Askush nuk mund të **vihet jashtë ligjit**,
- Askush nuk mund të **dëbohet**.

2. LIGJI PËR TË DREJTAT (BILL OF RIGHTS) 1689

- **E kufizon pushtetin absolutist**,
- **E garanton mbrojtje të të drejtave të njeriut**.

Ligji për të Drejtat

- e shpall **të paligjshëm pushtetin që pezullon ligjin ose që sundon pa ligj**,
- u jep **të drejtë qytetarëve t'i parashtrojnë peticione mbretit**,
- i shpall **të paligjshme urdhërat për ndjekje të parashtruesve të peticioneve**,
- **ndalon sulmet ose hetimet, jashtë parlamentit** (në gjyq, etj.), për fjalimet, diskutimet ose veprimet në parlament.

3. DEKLARATA PËR PAVARËSINË E SHBA-ve 1776

- Krijuesi i ka krijuar të gjithë njerëzit **të bababartë**,
- Ai ua ka dhënë atyre disa **të drejta të patjetërueshme**:
 - a) **jeta**,
 - b) **liria**,
 - c) **kërkimi i lumturisë**.
- **qeveritë janë krijuar për t'i siguruar këto të drejta**,
- qeveritë i nxjerrin **autorizimet e tyre nga pajtimi i njerëzve**, mbi të cilët ushtrohet pushteti.

Rrjedhimisht:

Kur qeveria bëhet **pengesë për jetësimin e këtyre qëllimeve**, populli, në çdo kohë, **ka të drejtë ta ndërrojë ose ta pezullojë qeverinë** dhe të formojë qverinë e re, si i duket më së miri, për të arritur lirinë dhe lumturinë.

Pra, Deklarata për Pavarësinë e SHBA-ve proklamon:

1. Të drejtën e **sovrانيتit**, që i takon popullit,
2. Të drejtën e **revolucionit** për t'u dhënë fund padrejtësive.

4. DEKLARATA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË QYTETARIT 1789

Njerëzit **lindin dhe jetojnë të barabartë në të drejta.**

Qëllimi i çdo rendi politik është **të mbrojë të drejtat natyrore** dhe të patjetërsueshme të njeriut:

1. **Liria,**
2. **Prona,**
3. **Siguria dhe**
4. **Rezistenca ndaj shtypësit.**

Deklarata e DNQ-së shpall:

- **të drejtën e fjalës,**
- **të drejtën e shkrimit, dhe**
- **të drejtën e shtypit.**

Deklarata **ndalon që dikush të jetë i shqetësuar për shkak të bindjes së tij.**

Kufinj të lirive të njeriut janë të përcaktuar vetëm me ligj.

(Ligji është shprehje e vullnetit të përgjithshëm të popullit).

Ligji duhet të jetë **i njëjtë për të gjithë, qoftë kur mbron qoftë kur ndëshkon.**

Pra, të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit.

Kjo do të thotë: çdo **detyrë, post dhe shërbim publik, mund t'i jepet çdo qytetari, sipas aftësive të tij dhe pavarësisht nga çdo dallim ndërmjet tyre, përveç dallimeve në virtytet dhe talentet e tyre.**

Përkufizimi i lirisë, si e drejtë e njeriut, në DDNQ: **njeriu mund të bëjë gjithçka, për aq sa nuk i bën dëm tjetërkujt.**

Pra, **shfrytëzimi i të drejtave natyrore të çdo njeriu, varet ose kufizohet nga të drejtat që u janë siguruar anëtarëve të tjerë të shoqërisë.**

Pushteti publik, i cili garanton të drejtat e njeriut dhe të qytetarit, është themeluar **për interesin e përgjithshëm, jo për interesin e atyre që u është besuar pushteti publik.**

Deklarata:

- **ndalon akuzat, burgosjet dhe mbajtjen arbitrare në burg, pa u bazuar në ligj, dhe**
- **dënon ata që nxisin, kryejnë ose mundësojnë kryerjen e urdhërave arbitrare.**

Deklarata ka dispozita që edhe sot konsiderohen **parime themelore të procedurës gjyqësore,** në të gjitha vendet e qytetëruara:

- **Askush nuk mund të dënohet, përveç në bazë të ligjit, të shpallur para kryerjes së deliktit,**

- **Cdo njeri konsiderohet i pafajshëm, derisa të mos konstatohet faj i tij.**
- Në rast të burgimit të domosdoshëm **ndalohet rreptësisht çdo masë e ashpër**, që **nuk do të ishte e nevojshme.**

Të drejtat e njeriut të DDNQ, të vitit 1789, janë konfirmuar dhe janë zgjeruar në **Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit, të vitit 1793**. Në të përsëriten të drejtat e njeriut, të deklaratës së parë dhe **shtohen edhe disa të drejta të reja:**

- E drejta e parashtrimit **të petitionit bartësve të pushtetit publik,**
- E drejta **për kryengritje,** kur qeveria i cënon të drejtat e popullit (**kjo është e drejta më e shenjtë dhe detyra më e domosdoshme,**
- E drejta e **tubimit paqesor,**
- E drejta e **ushtrimit të riteve religjioze,**
- **Detyra për të ndihmuar shoqërinë**, për t'i siguruar qytetarët që janë në pozitë të vështirë (sigurimi i punës, sigurimi i mjeteve për ekzistencë atyre që nuk janë të aftë për punë),
- **Krijimin e mundësive për shkollimin e të gjithë qytetarëve.**

Aktet e të drejtave të njeriut i bëjnë të paligjshme **kufizimet dhe privilegjet në shoqërinë feudale** dhe **pushtetin absolut të monarkëve.**

Ato janë **fitore për njohjen dhe afirmimin e të drejtave të njeriut.**